



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY



INFORMATOR



Zija Shemsiu pn., 60000,
Gjilan, Republika e Kosovës



Tel: 0280390112



www.uni-gjilan.net

Të nderuar lexues të

INFORMATORIT

të Universitetit “Kadri Zeka”



Duke ndarë kohën tuaj të çmueshme për Universitetin tonë, do të kuptoni besimin dhe shpresat e studentëve, profesorëve, asistentëve dhe të administratës së UKZ për të krijuar një universitet të ri, modern, cilësor dhe të pajtueshëm me tregun e punës.

Ne jemi universitet i ri, por kjo na ofron mundësinë që universitetin tonë ta orientojmë drejt qëllimeve të reja, me strategji e metoda të reja, në mënyrë që studenti i UKZ, me diplomën e tij, të jetë i barabartë me studentët e tjerë në vend, në rajon dhe në hapësirën europiane.

Universiteti është një mundësi e madhe për shoqërinë, me kusht që aty të kultivohet mendja e hapur e studentëve, të kultivohet mendimi kritik dhe të nxitet hulumtimi shkencor. Vetëm me këtë qasje studentët tanë mund t'ia kthejnë borxhin shoqërisë, atdheut dhe mbarë botës: përmirësimin e mirëqenies sociale, zhvillimin ekonomik si dhe promovimin e garës duke respektuar konkurrencën. Vetëm me këtë qasje Universiteti ynë mund ta luajë rolin e dritares dhe të portës së shoqërisë: një dritare e hapur për të parë më shumë dhe një portë e hapur për të komunikuar më shumë dhe të barabartë me botën. Vetë fjala universitet e ka këtë kuptim.

Kosova një ditë gjithsesi do të jetë pjesë e Bashkimit Europian. Me të hyrë në tregun europian, studenti i UKZ e ka në konkurrencë studentin europian, si për vendin e punës, si për hulumtime shkencore dhe për

çdo aspekt tjetër akademik. Mënyra e vetme për ta përballuar këtë konkurrencë është ngritja e cilësisë së mësimin në Universitet dhe hapja e mundësive për hulumtime.

Universiteti ynë e sheh si çështje parësore bashkëpunimin me hisedarët e arsimit akademik, duke nisur që nga institucionet profesionale, grupet shoqërore e deri edhe te shoqëria civile. Vetëm mbi një komunikim të rregullt për kërkesat e shoqërisë dhe mundësitë e saja në mund të projektojmë programet tona studimore.

Universiteti ynë e sheh si çështje shumë të rëndësishme edhe bashkëpunimin me universitetet e tjera, vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Mobiliteti i studentëve është shumë i frytshëm jo vetëm për studentët por edhe për vetë UKZ. Komunikimi i traditave, i kulturave, i ideve, i hulumtimeve dhe i prirjeve të tjera akademike është në frymën dhe në shpirtin e Universitetit tanë.

Universiteti ynë e sheh si begati strukturën multi-kulturore të shoqërisë sonë, si dhe multikulturalizmin e shoqërive përreth Republikës së Kosovës. Prandaj, ne e shohim të rëndësishëm bashkëpunimin me të gjitha këto struktura sociale dhe orientimin e programeve studimore në këto kahe.

Për të arritur këto qëllime, UKZ duhet të krijojë dhe ta ketë gjithnjë një staf akademik të aftë dhe një administratë efektive. Ne jemi të hapur dhe kërkues për secilin person akademik, i cili mund të sjellë risi në UKZ, në cilëndo fushë akademike dhe në cilindo aspekt akademik.

Ne po synojmë një universitet të ri-për një shoqëri të re.

Na priftë e mbara të gjithëve!



Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi
Rektor - Rector



↑ Ceremonia e parë e diplomimit të studentëve të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan

Universiteti

"KADRI ZEKA"

Gjiilan

Me rreth 6000 mijë studentë, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjiilan i themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës më datë 6 mars 2013, ndjek përsosmëri në hulumtim dhe mësimdhënie.

 **Mision i UKZ-së** e përcakton identitetin, qëllimet dhe rolin e Universitetit në aspektin akademik : Edukimi i studentëve me të arriturat më bashkëkohore të shkencës, teknologjisë, kultivimi i shpirtit ndërmarrës dhe krijues, e bënë Universitetin "Kadri Zeka" të gatshëm për t'u përballur me sfidat e së ardhmes në një botë dinamike dhe në ndryshim të përhershëm në tregun e punës.

Parimet e


ARSIMIT TË LARTË


European (HEAL)

Universiteti "Kadri Zeka" përpiqet për të mbështetur cilësinë më të lartë në të gjitha aktivitetet e saj. Vazhdimisht punohet për të siguruar dhe përmirësuar kualitetin në mësim, duke monitoruar dhe vlerësuar performancën e stafit të saj që ka rreth 40 mësindhënës (profesor, ligjërues dhe asistent) të rregullt. UKZ në Gjiilan, udhëhiqet nga Parimet e Arsimit të Lartë European (HEAL) të cilat janë bazë e programeve studimore dhe syllabuseve të të gjitha programeve dhe fakulteteve. HEAL mbështet institucionet e arsimit të lartë në rritjen e përpjekjeve të tyre për të nxitur mirëkuptimin ndërkulturor, të menduarit kritik, tolerancë fetare, barazi gjinore dhe vlerat demokratike dhe qytetare, për të forcuar vlerat shoqërore evropiane dhe globale për një shoqëri gjithëpërfshirëse.

↳ Hyrja e Universitetit "Kadri Zeka"









↑ Studentët gjatë mbajtjes së provimeve

Themelimi

PËRMBUSHJA


e kriterëve për akreditim

Universiteti “Kadri Zeka” ofron mundësi të shkëlqyera për mësim dhe përbëhet prej katër njësive akademike, me shtatë programe studimi Baçelor të akredituara deri më vitin 2019, dhe 2 programe të studimit Master, në të cilat studiojnë rreth 6000 studentë.

Themelimi i UKZ-së bëri të mundur përfshirjen e numrit më të madh të studentëve të rajonit të Gjilanit, Luginës së Preshevës dhe viseve të tjera në shkollimin e lartë universitar. Fakultetet e Universitetit procesin e tyre mësimor akademik e zhvillojnë në kuadër të programeve të studimit të bazuar në Statutin e Universitetit.


Studentët në Universitetin "Kadri Zeka" janë më premtues

Fakulteti / Programi i studimit	Gjithsej
Edukim / Fillor	831
Edukim / Parafillor	569
Juridik / Juridik	1691
Ekonomik / Banka, Financa dhe Kontabilitet	1112
Ekonomik / Menaxhment	1097
Ekonomik / Marketing	556
Shkenca Kompjuterike / Shkenca Kompjuterike	467
Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike (Master)	51
E-Qeverisja (Master)	58
Gjithsej	6432



Numri i studentëve të diplomuar në UKZ

Fakulteti / Programi i studimit	Gjithsej
Edukim / Fillor	35
Edukimi / Parafillor	8
Juridik / Juridik	31
Ekonomik / Bana, Financa dhe Kontabilitet	44
Ekonomik / Menaxhment	46
Ekonomik / Marketing	9
Shkenca Kompjuterike / Shkenca Kompjuterike	26
Gjithsej	200





➔ Teuta S. Gashi -
studente
e Fakultetit Juridik



Fatmir S. Kastrati – student ⬆
i Fakultetit të Edukimit

⬇ Shkencave Kompjuterike



Enis I. Rushiti – student
i Fakultetit Ekonomik



*Prof. asoc. dr. Januz Dervodeli
Dekan i Fakultetit të Edukimit*

FAKULTETI I EDUKIMIT ka mision promovimin e arritjeve të studentëve duke nxitur për- sosmërinë arsimore dhe duke siguruar qasje të barabartë

Aftësimi i mësimdhënësve dhe edukatorëve në frymë bashkëkohore, aftësimi për t'u përballë me një botë e cila vazhdimisht po ndryshon është misioni dhe vizioni i Fakultetit të Edukimit. Këtu punohet në ngritjen e mësimdhënësve dhe edukatorëve të rinj duke sjell përvoja të avancuara të vendeve perëndimore për aftësim profesional të mbështetur në praktikë dhe në krijimin e lidhjeve të natyrshme dhe të qëndrueshme midis fakultetit, shkollës dhe komunitetit arsimor.

PARIMET DHE QËLLIMET

- Fakulteti i Edukimit siguron përvoja të praktikës së mësimdhënies të cilësisë së lartë, nga të cilat të gjithë studentët do të kenë rastin që në mënyrën më të mirë



↑ Zhvillimi i mësimet në kabinetin e muzikës

ta zhvillojnë potencialin e tyre për t'u bërë mësimdhënës efektivë dhe të suksesshëm në karrierë.

- Studentët do të përgatiten për ta zbatuar kurrikulin e edukimit parashkollor dhe të shkollave fillore në Kosovë, me qëllim për t'i angazhuar nxënësit në aktivitete të nxënies sipas filozofisë së edukimit me fëmijën në qendër, e cila premtan një mësimnxënie gjatë gjithë jetës.

- Shkollat, mësimdhënësit mentorë dhe Fakulteti i Edukimit funksionojnë si partnerë në përgatitjen e mësimdhënësve.

- Të gjithë studentët të dalin mësimdhënës të pajisur me njohuri, të shkathtë dhe reflektivë, të cilët janë të përgatitur për t'iu përgjigjur sfidave dhe për t'i plotësuar përgjegjësitë e të qenit mësimdhënës profesionistë në Kosovë dhe më gjerë.

- Të gjithë studentët të përgatiten mirë, duke kaluar nëpër një proces të Praktikës Pedagogjike të organizuar, të udhëzuar dhe të mbikëqyrur nga stafi mësimdhënës i Fakulteti të Edukimit.

Gjatë monitorimit të studentëve të Fakultetit

↓ të Edukimit rreth mësimet praktik





*Prof. ass. dr. Sadik Haxhiu
Dekan i Fakultetit Juridik*

FAKULTETI JURIDIK ka për mision që studentët të bëhen mendimtarë, kritikë dhe socialë. Gurthemel i Fakultetit Juridik është edukimi ligjor

Fakulteti Juridik dallohet me programe studimi të modeleve bashkëkohore, me një staf akademik me mjaft eksperiencë, juristë – praktik të së

Drejtës, figura të njohura nga fusha e Drejtësisë që me aktivitete të nduardurta i përgatisin me seriozitet studentët për tregun e punës.

Fakulteti Juridik në Universitetin “Kadri Zeka” mbetet një prej zgjedhjeve më të mira për të rinjtë e Komunës së Gjilanit dhe komunave tjera, si dhe studentët e Luglinës së Preshevës dhe Maqedonisë. Ai konsiderohet si një nga degët kryesore në nivelet e studimit; Bachelor dhe Master që ofron programe studimi me modelet më të mira bashkëkohore bazuar në përvojat dhe metodat e universiteteve prestigjioze perëndimore.

Fakulteti ynë bashkëpunon me fakultetet eminente juridike në vend, në rajon dhe më gjerë me përvojë të madhe të arsimit juridik si dhe anëtarë të institucioneve të ndryshme profesionale juridike, në vend dhe më gjerë.

↓ Studentët mësojnë bashkërisht





Vizioni dhe Misioni

Të jemi një Fakultet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë kosovare me programet tona, në të gjitha ciklet e studimeve, që të ofrojnë një numër të konsiderueshëm të disiplinave juridike të formuluara në pajtim me Procesin e Bolonjës dhe eksperiencat evropiane dhe amerikane, përmes implementimit të plotë të sistemit evropian të transferim të kredive, duke mundësuar mobilitetin e studimeve në vend dhe jashtë vendit, me ç'rast sigurohet njohja e diplomës nga vendet evropiane të përfshira në procesin e Bolonjës. T'u japim studentëve një edukim cilësor, në lëmin e drejtësisë, t'i shërbejmë dijes së shoqërisë në përparimin e vazhdueshëm të arsimit profesional juridik në pajtim me standardet më të larta të cilësisë dhe kualitetit, duke dhënë një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit juridik, shkencës juridike dhe profesionit juridik në Kosovë dhe më gjerë.

↓ Studentët pas mbrojtjes së temës së diplomës





**MENAXHMENT
& INFORMATIKË**



**BANKA, FINANCA
& KONTABILITET**



MARKETING



*Prof. ass. dr. Gëzim Tosuni
Dekan i Fakultetit Ekonomik*

FAKULTETI EKONOMIK zgjeron horizonte për menaxhim me përgjegjësi shoqërore të sfidave të biznesit dhe ekonomisë. Deri në vitin 2022 do të jemi institucion i zgjedhur në biznes dhe ekonomi në vend dhe rajon për të bërë kërkime, për të mësuar dhe për të krijuar zgjidhje të zhvillimit të qëndrueshëm

Programet e studimit në Fakultetin Ekonomik janë në përputhje me programet e dy universiteteve anëtare të Procesit të Bolonjës, përkatësisht Universitetin e Lubjanës dhe Universitetin e Zagrebit. Fakultetin Ekonomik ka këto programe studimi:

- Menaxhment dhe Informatikë /BA, i cili krijon mundësi për studentët që të fitojnë njohuri dhe aftësi që të jenë në gjendje të zhvillojnë sektorin privat, të hulumtojnë nevojat e tregut në dimensionet e një ekonomie tregu të përparuar;



↑ Zhvillimi i ligjëratave në UKZ

- Banka, Financa dhe Kontabilitet /BA, që ofron njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike në fushën e Bankave, Financave dhe Kontabilitetit. Karakteri i dallues i këtij programi qëndron në kombinimin e tri disiplinave të ndryshme, të cilat ofrojnë një bazë të shkëlqyeshme për të zhvilluar karrierë në industrinë e shërbimeve financiare, pastaj në fushën e kontabilitetit, por edhe në institucione publike;

- Marketing / BA, synon që pikërisht përmes tregut të punës, të përgatisë studentët me njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike, që do të mund të shërbejnë në zhvillimin e sektorit prodhues dhe shërbyes.

Në vitin 2016 rreth 50 studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Kadri Zeka" kanë mbrojtur temën e diplomës, duke u bërë kështu të parët që përfundojnë me sukses studimet e nivelit Baçelor në Fakultetin Ekonomik, respektivisht në programin Banka Financa dhe Kontabilitet.

↓ Mësim rekreativ





*Prof. ass. dr. Xhevdet Thaqi
Dekan i Fakultetit
të Shkencave Kompjuterike*

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE – PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike FSHK-ja ofron njohuri themelore dhe të avancuara për sfidat teknologjike dhe softuerike në fushën e shkencave kompjuterike si dhe zbatimin e tyre në industrinë e IT-së dhe të zhvillimit të softuerëve për Ueb dizajn dhe Ekonomi.

Duke ditur se inxhinierët në kohët moderne duhet të jenë në gjendje të zgjidhin probleme dhe çështje gjithnjë e më komplekse, për të hartuar dhe për të zbatuar paketa softueri, për të hartuar dhe për të zbatuar zgjidhje në rrjete kompjuterike, apo për të përmirësuar dhe për të mirëmbajtur teknologjitë e informacionit, ato që do të ofrohen në këtë program Baçelor, do të mbulojnë teknikat të cilat do të rrisin produktivitetin në zhvillimin e programeve softuerike dhe të teknologjisë së informacioneve.



↑ Njëri nga kabinetët e Informatikës

Për këtë qëllim, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, për nivelin Baçelor, ofron një bazë ndërdisiplinore, me studime të specializuar në dy fusha kryesore:


- Inxhinieri Softuerike dhe Web Design, si dhe
- Informatika për Ekonomi


Në kuadër të FSHK-së, në një të ardhme të afërta, planifikohet hapja e programeve të reja studimore nga fusha e IT-së.

Gjatë vizitës së ekspertëve të akreditimit
 ↓ në njërin nga kabinetët e Informatikës



ORGANOGRAMI I UKZ-së








↑ Gjatë pritjes së studentëve me rastin e fillimit të vitit të ri akademik

Stafi Akademik dhe Administrativ i Universitetit “Kadri Zeka” është një vend frymëzues, i cili tërheq studiuesit më të mirë në vend dhe rajon





↑ Takim mes Rektorit dhe stafit të rregullt akademik

Fakulteti /Programi i studimit	Të rregullt		Të angazhuar		Staf tjetër (administrativ)	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Fakulteti i Edukimit	3	6	10	12	3	1
Fakulteti Ekonomik	1	10	10	19	1	2
Fakulteti Juridik	2	10	3	16	1	0
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	2	5	3	6	0	1
Administrata Qendrore –Rektorati	0	0	0	0	2	7
Gjithsej	8	31	26	53	7	11

↓ Në UKZ gjithçka është e shkëlqyer



Parlamenti

STUDENTOR

UKZ

Sipas statutit të Universitetit “Kadri Zeka”, Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të Universitetit me këto organe:

1. Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit;
2. Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike.

Parlamenti i studentëve është organi suprem i përfaqësimit të studentëve, kurse Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike. Kryesia e Parlamentit Studentor si organ suprem i përfaqësimit të studentëve është zgjedhur me shumicën e anëtarëve të Parlamentit Studentor.


↓ Parlamenti Studentor i UKZ-së



Buxheti aktual vjetor dhe projeksioni deri 2019

Stabiliteti financiar i UKZ-së kryesisht bazohet në grantin qeveritar. Granti qeveritar është fond i lejuar nga buxheti i Kosovës, i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore.

Kategoritë ekonomike	Kufijtë buxhetorë 2017	Projeksioni buxhetor 2018	Projeksioni buxhetor 2019
Pagat dhe mëditjet	930,214.00 €	1,500,000.00 €	1,600,000.00 €
Mallrat dhe shërbimet	316,339.00 €	450,000.00 €	500,000.00 €
Shpenzimet komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Subvencionet dhe transferet	10,000.00 €	100,000.00 €	120,000.00 €
Shpenzimet kapitale	500,000.00 €	500,000.00 €	2,500,000.00 €
TOTAL:	1,806,553.00 €	2,600,000.00 €	4,770,000.00 €



Projektet dhe hulumtimet e UKZ-së

Studentët dhe mësimehënësit e Universitetit "Kadri Zeka" zhvillojnë me sukses projekte shkencore, hulumtuese dhe praktike të nevojshme për tregun e punës.

Gjatë vitit akademik 2016/2017 janë realizuar projektet e para të cilat zgjuan interesim nga institucionet publike dhe private të ndërmarrjeve.



↑ Studentët e UKZ-së gjatë vizitës në Greqi

Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në udhëheqjen e dekanit prof. dr. sc. Xhevdet Thaçi dhe stafit akademik, kanë prezantuar punën e tyre në përpilimin elektronik të orarit mësimor, ueb faqes së shkollave, digjitalizimin të punës dhe shërbimeve në stacionin e autobusëve si dhe aplikacionin për menaxhimin e pagesave dhe shërbimeve hoteliere.

Projekti E-learning

Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjiilan, kanë punuar projektin e programit E-learning, që ka për qëllim përdorimin e teknologjisë për të mundësuar njerëzve për të mësuar në çdo kohë dhe kudo. E-Learning si software i ri të lejon krijimin e një ambienti efektiv të mësimi, si dhe E-learning është një qasje e re e cila përmban në vete të mësuarit në njërën anë dhe teknologjinë informative dhe kompjuterët në anën tjetër, është shtrirje e të mësuarit dhe internetit në një vend.

↓ Gjatë prezantimit të projektit E-learning



NDËRKOMBËTARIZIMI

Universiteti "Kadri Zeka" është pjesë e disa projekteve ndërkombëtare. UKZ ka traditë shkencore për t'u pasuruar me njohuri dhe përvoja të ndryshme



Në kuadër të programit Erasmus+ të Bashkimit Evropian (EU), u kualifikua projekti ndërkombëtar i përbashkët ***"Ready for business – integrating and validating practical entrepreneurship skills in engineering and ICT studies RE-BUS"*** në të cilin Universiteti "Kadri Zeka" është partner i plotë në projekt.

Ky projekt gjatë tri viteve të ardhshme (2017-2019) do të fokusohet në zhvillimin, testimin, validimin dhe krijimin e moduleve bazike të trajnimit për zhvillimin e aftësive kompetencave të ndërmarrësisë së studentëve nga fusha e TI. Në këtë mënyrë studentët e Universitetit Kadri Zeka në Gjilan do të kenë mundësi të fitojnë njohuritë dhe kompetencat më bashkëkohore nga kjo fushë dhe të participojnë në trajnime të tilla.

Project No: 573664-EPP-1-2016-BA-EPPKA2-CBHE-JP



Mbështetur nga UE në kuadër të programit ERASMUS +, Universiteti Kadri Zeka në Gjilan është partner i plotë në projektin ***"Entrepreneurial Universities for Industrial Alliance – EUFORIA"***

Ky projekt ka për qëllim të zhvilloj dhe vendos lidhje në mes universiteteve dhe ndërmarrjeve në mënyrë që të ngritet mësimdhënia dhe mësimnxënia, të përmirësohen Kurikulat në vij me kërkesat e ndërmarrjeve dhe përmirësimi i financimit të qëndrueshëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Project No: 561695-EPP-1-2015-1-UK-EPPKA2-CBHE-JP



Universiteti Kadri Zeka në Gjiilan, që në vitin e parë të themelimit u bë pjesë e projekteve ndërkombëtare mbështetur nga UE në kuadër të programit ERASMUS Mundus. Fjala është për projektin ***“GreenTech: Smart & Green Technologies for Innovative and Sustainable Societies in WB”***

Projekti Green-Tech-WB në kuadër të Programit Erasmus Mundus është i fokusuar në trekëndëshin: bashkëpunim në arsimin e lartë, hulumtim dhe inovacion dhe fushat tematike të teknologjive të gjelbra. Project No: 551984-EM-1-2014-1-ES-ERA MUNDUS-EMA21



UKZ është anëtar themelues i Balkan Universities Association BUA

Universitetit “Kadri Zeka” është anëtar themelues i Asociacionit të Universiteteve Ballkanike (BUA). Asociacioni i Universiteteve të Ballkanit



Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan, është anëtar i plotë i Asociacionit të Mësimdhënësve Evropian.

Asociacioni i Mësimdhënësve Evropian (ATEE) është një organizatë jofitimprurëse evropiane, qëllimi i të cilit është përmirësimi i cilësisë së arsimit në Evropë dhe mbështetjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe edukatorëve të institucioneve në të gjitha nivelet. Projektet kërkimore aktuale të ATEE në të cilat participon edhe Universiteti “Kadri Zeka”, janë:

- RDC Teacher Education and Digital Technology, project: Massively Open Online Courses (MOOCs);
- RDC Science and Mathematics Education, project: Developing constructivist approaches to teaching and learning science and mathematics;

është një shoqatë e lirë e universiteteve themeluese dhe është e hapur për universitetet e tjera nga zona e Ballkanit. Universiteti “Kadri Zeka” është anëtar i këtij Asociacioni me të drejta të plota.

KONFERENCAT

Në Tryezën Debatuese në organizim të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan dhe GIZ-CDBE (Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Bazë) “Klasa I deri V, një apo më shumë mësues”, nga pjesëmarrësit në tryezë janë nxjerr disa rekomandime: Përpilimi i planprogramit në fusha të specializuara për mësimdhënës të shkollave fillore, Trajnime/seminare me mësimdhënësit aktual (pilotim nga Fakulteti i Edukimit si dhe të organizohet testi më mësimdhënës të arsimit fillor). Menaxhmenti i Universitetit “Kadri Zeka” të filloj bisedimet me MASHT për aprovimin e kësaj ide. Të intensifikohet puna në shtimin e orëve të matematikës dhe gjuhës dhe zvogëlimi i orëve nga lëndët tjera. Ndarja e mësimdhënësive sipas shkathtësive (të kryhet sipas vullnetit të mësimdhënësive). Të ketë më shumë se një mësimdhënës në mënyrë që të lehtësohet puna e mësimdhënësive dhe kështu të bëhet vlerësimi sa më real i nxënësive. Të identifikohen shkathtësitë e mësimdhënësive përmes një testi ku do të kihet parasysh nota mesatare nga studimet si dhe rezultatet e pritshmërisë së nxënësive. Të kërkohej mbështetje nga Institucionet qendrore dhe lokale si dhe nga drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave fillore, që të ndihmojnë në implementimin e këtyre rekomandimeve. Ky organizim i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan dhe GIZ-CDBE (Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Bazë) me temë “Klasa e I-V, një apo më shumë mësues” ka për qëllim të stimuloj një diskurs akademik dhe një debat të politikave.

↳ Nga Tryeza Debatuese “Klasa I deri V, një apo më shumë mësues”





↑ Foto gjatë tryezës shkencore “Nga shqiptarët ose serbët deri te shqiptarët dhe serbët”

- Programi “Guest Speaker”
- Tryeza Debatuese Shkencor “Nga shqiptarët ose serbët deri te shqiptarët dhe serbët”
- Konferenca Ndërkombëtare “Arsimi dhe edukimi në shoqëritë me diversitet kulturor”
- Konferenca “Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro-Hungarinë nga Shek XIX deri në ditët tona”, Gjilan
- Konferenca me temën “Ndryshimet në shoqëri përmes reformave në arsim” Gjilan
- *Konferenca shkencore mbarëshqiptare kushtuar 130 vjetorit të Mësonjëtores së Parë Shqipe- Vatër e arsimimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve”, Korçë, 06.03.2017*

BASHKËPUNIMET

UKZ si anëtar i disa organizatave ndërkombëtare kërkimore i takon institucioneve më prestigjioze në vend dhe më gjerë, duke nxjerrë në pah bashkëpunime me Universitete brenda dhe jashtë Kosovës.

• Universiteti Zug, Zvicër

Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan dhe Universiteti i Edukimit në Zug Brigit Eriksson – Hotz, kanë marrëveshje bashkëpunimi. Përmes marrëveshjes të dyja palët do të organizojnë aktivitete të përbashkëta.

Mundësitë për të bashkëpunuar në kuadër të një shkolle verore (Gjilan)

Mundësitë për bashkëpunim në kuadër të serisë së ligjëratave (Gjilan)

Mundësi për bashkëpunim në hulumtim (p.sh.: Baçelor ose Master tezës jashtë vendit)

Mundësi për nxënësit punë praktike në kuadër të bashkëpunimit

- Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, Shqipëri
- Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Shqipëri
- University of Rijeka në Kroaci
- Great Lakes Colleges Association

↓ Foto gjatë qëndrimit ne Zug të Zvicrës





↑ Rektori prof. asoc. dr. Bajram Kosumi gjatë takimit me dy studentët bursistë të programit Erasmus +, Xheneta Vranovci dhe Buen Bajrami

- Deutsche gesellschaft für Internationale Zusammenarbit (GIZ)
- Universiteti i Sarajevës
- Budapest Business School
- Universiteti Politeknik delle Marche Ancona, Itali

UKZ nxit bashkëpunimin ndërkombëtar në hulumtim dhe mësimdhënie, dhe promovon shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik. Në kuadër të kësaj janë katër student, një profesor dhe një asistent që kanë fituar bursë studimore si pjesë e aktiviteteve universitare me karakter ndërkombëtar. Ky rezultat i bursistëve është arritur krahas projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunimeve mes Universitetit “Kadri Zeka” dhe universiteteve të ndryshme nëpër botë.



↑ Rektori i Universitetit “Kadri Zeka” prof. asoc. dr. Bajram Kosumi së bashku me Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Arsim Bajrami dhe me disa Rektorët e Universiteteve tjera Publike të Kosovës, gjatë vizitë zyrtare studimore në SHBA

- Nigde University, Nigde, Turqi
- Universiteti Trakya, Edirne, Turqi
- Universiteti Kastamonu, Turqi
- Universiteti “Recep Tayip Erdogan”, Turqi

Në pritje

- James Medison University
- Universiteti Perugia, Itali

↓ Ekspertët e Akreditimit gjatë qëndrimit në UKZ, vizituan edhe Laboratorin e Shkencave të Natyrës



Biblioteka

UKZ është i përkushtuar për ndjekjen e dijes, por edhe mban përgjegjësi për ofrimin e një baze shkencore për vetëreflektim në shoqëri, duke kontribuar në masë të madhe në drejtim të zhvillimit të saj pozitiv duke ofruar literaturë në bibliotekën e Universitetit si për stafin akademik po ashtu edhe për studentët.

Biblioteka e Universitetit "Kadri Zeka" ka një hapësirë rreth 500 m². Ka gjithsej 3 salla leximi, të cilat shfrytëzohen mjaft shumë për lexim.

Salla e bibliotekës është e përshtatshme për lexim dhe është relativisht e pasur me libra, ka gjithsej 45100 ekzemplarë. Prej këtyre shumica janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate, por ka edhe në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera.

↓ Njëra nga sallat e leximit në bibliotekë





↑ Menaxhmenti i UKZ-së

ORGANIZIMI

Rregulloret dhe procedurat për zhvillimin/ rishikimin dhe aprovimin e kurrikulave të reja bëhen duke u bazuar në Deklaratën e Bolonjës duke e respektuar një zinxhir hierarkik të paraqitur më poshtë:

- Këshilli Drejtues
- Rektori
- Senati i Universitetit
- Sekretari i Përgjithshëm
- Dekani
- Këshilli Fakultetit

↓ Këshilli Drejtues i UKZ-së









UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY



Zija Shemsiu pn., 60000,
Gjiilan, Republika e Kosovës



Tel: 0280390112



www.uni-gjilan.net